



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3002/ 6 prot

Datë 20.11.2025

V E N D I M
Nr. 1723 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-62567-09-24-2025, me objekt “Blerje konteniere (kazane mbeturinash) te galvanizuar per mbetjet urbane te bashkise Shijak” me fond limit: 8.333.333 (tetemilione e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë , pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 06-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shijak
Adresë: Lagja “Erzen” Shijak.

Ankimues: Operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK me NIPT L82523203F, me adresë: Lagjia “Luigj Gurakuqi”, Blv “Aqif Pasha”, Hotel Skampa, Kati 5, Nr. 303, Elbasan.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25-09-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” REF-54793-07-14-2025, me objekt “Blerje konteniere (kazane mbeturinash) te galvanizuar per mbetjet urbane te bashkise Shijak” me fond limit: 8.333.333 (tetemilion e treqind e tridhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë e tre) leke , pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 06-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Në datën 10.10.2025 Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, ka bërë vlerësimin e ofertave të paraqitura nga ofertuesit të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1-“Arteo 2018” SHPK	6,258,000	lekë	skualifikuar
2-“In Auto” Shpk	6.968.000	lekë	skualifikuar
3-“Luar BROS” SHPK	8,220,000	lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 17.10.2025 autoriteti kontraktor ka bërë publikimin e njoftim fituesit paraparak, në S. P.E.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/6002, datë 23.10.2025 dhe me nr. 3002/2025 Prot., dhe protokolluar me datë 23.10.2025 e operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK , duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.5 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprahe” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3002/1 prot., datë 24.10.2025, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e skualifikimit të ofertës së paraqitur nga ankimuesi.

II.6 Më datë 04.11.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Shijak, nëpërmjet sistemit,DHE SHËRBIMIT POSTAR ka ardhur shkresa me me nr. 5540/1prot., datë 04.11.2025 ku bashkëlidhur shkresës gjendet vendimi NR. 384 datë 04.11.2025 për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues protokolluar me tonën me nr. 3002/3 datë 05.11.2025, për procedurën objekt – ankimi, ku rezulton se AK nuk e ka pranuar ankesën e paraqitur, me argumentimin si vijon:

Në vijim të ankesës suaj për procedurën e prokurimit me Objekt : Blerje kontenierë (kazane mbeturinash) të galvanizuar për mbetjet urbane të bashkisë Shijak” dhe nr REF-62567-09- 24-2025, ju keni paraqitur ankesë me Objekt “Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertes” . Referuar ankesës suaj Titullari i institucionit ka ngritur grupin e punës për shqyrtimin e ankesave i cili shqyrtoi rrethanat e faktet si vijon : Së pari , grupi i punës shqyrtoi raportin përmbledhës të KVO mbi procedurën e prokurimit, në të cilën janë detajuar objekti i procedures, data e hapjes se ofertave, OE pjesemarrres, OE te kualifikuar, OE te skualifikuar me arsyet përkatëse te skualifikimit si dhe lejin e Njesise se prokurimit per vijimin procedurës . Komisioni i vlerësimit të ofertave për këtë procedurë prokurimi i është referuar Ligjit nr 162 datë 23.12.2020, i ndryshuar përkatësisht neni 92 pika 1 dhe VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021 ndryshuar me Vendimin Nr. 498, datë 1.8.2024 ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024) i ndryshuar për të cilën shprehet : Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të

reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë. KSHA duke marrë nën shqyrtim dokumentat provues, si dhe nisur nga natyra e objektit të prokurimit është e mendimit se vendimi i KVO qëndron pjesërisht. Ankesa juaj nuk pranohet në pikën ku : KVO ka konstatuar mungesën në sistem të APP të Vërtetimit të Konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për vitet 2023, 2022 sipas kërkesës së DST. Ky konstatim qëndron .

Pra për sa më sipër KSHA VENDOSI :

1. Ankesa juaj nuk pranohet

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Arteo 2018*” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “ - Pasqyrat financiare për vitin 2024 të ngarkuara në SPE nuk janë të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve Elbasan sipas kërkesave të DST, pika 2,2 b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Pasqyrat Financiare të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të certifikuara nga organet tatimore dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar. Na keni skualifikuar pa te drejte pasi shoqëria jone ARTEO 2018 shpk e plotëson kërkesën e DST, ku kërkohej; 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar: b. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Pasqyrat Financiare të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të certifikuara nga organet tatimore dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të një pasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit Në sistem kemi paraqitur Pasqyrat Financiare të viteve 2022, 2023 dhe 2024 konform kërkesës së mesiperme, pra Pasqyrat Financiare të viteve 2022, 2023 dhe 2024 janë të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan. Kërkojme nga ana juaj rivlerësimin e procedurës dhe kualifikimit të shoqërisë sone si oferte të cilat i plotëson të gjitha kërkesat sipas DST dhe me të favorshme ekonomike ” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 7 “kriteret e veçanta të kualifikimit”, në pikën 2.2. autoriteti kontraktor ka përcaktuar: Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Operatori ekonomik të paraqese vertetim nga administrata tatimore për xhiron mesatare vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024, ku të paktën në njërin nga këto vite, xhiro minimale duhet të jete jo më pak se 40 % e fondit limit që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

b. Operatori ekonomik duhet të paraqese Pasqyrat Financiare të viteve 2022, 2023 dhe 2024 të certifikuara nga organet tatimore dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar) dhe kestet e maturara për vitin 2025 . Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

.

III.1.2 Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik “Arteo ” SHPK , ka ngarkuar në sistemin elektronik dokumentacionin si në vijim:

- Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më datë 31 dhjetor 2022;
- Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2023;
- Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2024, (bashkëlidhur shkresa me nr. 2247 /1 datë 15.04.2025 nga Drejtoria Tatimore Rajonale Elbasan);
- Shkresa nr. 2247/1 prot., datë 15.04.2025 lëshuar nga Drejtoria Tatimore Rajonale Elbasan me lëndë “ Kthim Përgjigje ”, drejtuar subjektit “Arteo 2018” SHPK, me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës suaj nr 2247, date 14.04.2025, po ju vendosim në dispozicion kopje të Pasqyrave Financiare të subjektit "ARTEO 2018", me Nipt L82523203F, periudha 2024 dorëzuar dhe ngarkuar elektronikisht në sistemin informatik tatimor C@TS në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan date 04.03.2025. Sjellim në vëmendjen tuaj në kuadër të Nenit 29 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë" i

ndryshuar, Pasqyrat financiare 2024 quhen të pranuar për efekte fiskale kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojnë dy muaj pas dorëzimit të tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk përgjigjet zyrtarisht.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë: Pasqyrat financiare Viti 2024 - 13 Fletë”

III.1.3. Neni 2 Qëllimi i ligjit 162/2020 Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; 32 d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmanjin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare . 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. 3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. 4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e

përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit .

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”

III.1.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës.

Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, a. Operatori ekonomik të paraqesë vërtetim nga administrata tatimore për xhiron mesatare vjetore të viteve 2022, 2023 dhe 2024, ku të paktën në njërin nga këto vite, xhiro minimale duhet të jete jo më pak se 40 % e fondit limit që prokurohet.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më datë 31 dhjetor 2022, Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2023, Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2024, Shkresa nr. 2247/1 prot., datë 15.04.2025 lëshuar nga Drejtoria Tatimore Rajonale Elbasan me lëndë “Kthim Përgjigje”, drejtuar subjektit “Arteo 2018” SHPK, me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës suaj nr 2247, date 14.04.2025, po ju vendosim në dispozicion kopje të Pasqyrave Financiare të subjektit “ARTEO 2018”, me Nipt L82523203F, periudha 2024 dorëzuar dhe ngarkuar elektronikisht në sistemin informatik tatimor C@TS në Drejtorinë Rajonale Tatimore Elbasan date 04.03.2025. Sjellim në vëmendjen tuaj në kuadër të Nenit 29 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Pasqyrat financiare 2024 quhen të pranuar për efekte fiskale kur miratohen nga administrata tatimore ose kur kalojnë dy muaj pas dorëzimit të tyre zyrtar dhe administrata tatimore nuk përgjigjet zyrtarisht.

Bashkëngjitur po ju dërgojmë: Pasqyrat financiare Viti 2024 - 13 Fletë”

Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, kriterit 2.2. të kriterëve të veçantë të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, si dhe arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “ARTEO 2018” SHPK me arsyen se “[...] Pasqyrat financiare për vitin 2024 të ngarkuara në SPE nuk janë të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve Elbasan sipas kërkesave të DST, pika 2,2 b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Pasqyrat Financiare të viteve 2022,

2023 dhe 2024 të çertifikuara nga organet tatimore dhe të shoqeruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik si në vijim: “[...]Pasqyrat financiare për vitin 2024 të ngarkuara në SPE janë të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve Elbasan sipas kërkesave të DST si dhe referuar shkresës që mban nr. 2247/1 prot., datë 15.04.2025 lëshuar nga Drejtoria Tatimore Rajonale Elbasan, KPP vlerëson se referuar nenit 82 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal, Komisioni gjykon se dokumentacioni i ngarkuar në SPE “[...] Pasqyrat financiare për vitin 2024 si dhe shkresën shoqëruese me nr. 2247/1 prot., datë 15.04.2025 lëshuar nga Drejtoria Tatimore Rajonale Elbasan, për operatorin ekonomik ankimues, plotëson kriterin e parashikuar në dokumentat standarte të tenderit nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Arteo 2018” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1.Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Arteo 2018” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. me Nr. REF-62567-09-24-2025, me objekt “Blerje konteniere (kazane mbeturinash) te galvanizuar per mbetjet urbane te bashkise Shijak ” me fond limit: 8.333.333 (tetemilion e treqind e tridhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë

e tre) lekë , pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 06-10-2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik sipas konstatimeve të mësipërme të shprehura në këtë vendim.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Arteo 2018" SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

